



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Raporti vjetor IADK 2009



Dhjetor 2009

Kush jemi dhe cka punojmë

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) është OJQ vendore e specializuar për bujqësi, këshilla, hortikulture, blegtori dhe përpunim shëtpik e cila është themeluar në dhjetor 2004. IADK është OJQ në nivel kombëtar por për gjatë këtyre viteve ka vepruar në regjionin e Mitrovicës.



Qëllim i IADK-së:

Krijimin e një mjedisi social-ekonomik më të zhvilluar në zonat rurale duke mbështetur aktivitetet bujqësore, ri-integrimin e njerëzve të kthyer, zvogëlimin e varfërisë, zvogëlimin e importit promovimin e praktikave të mira bujqësore, zvogëlimin e papunësisë pa dallim feje,etniteti apo gjinie,

Gjatë këtyre viteve një kontribut të madhe në ngritjen e kapaciteteve dhe në transferimin e aseteve tek IADK ka luajtur Lutheran Word Federation (LWF) e cila edhe me tuatje është duke e ndihmuar IADK-n.

Ëndërrat tona në zhvillimin e Bujqësisë janë duke u bërë realitet falë kontributit të madhe të donatorëve: Evangelischer Entwicklungsdienst (EED) nga Gjermania dhe Finn Church Aid (FCA) nga Finlanda të cilat e kanë mbështetur programin e bujqësisë së Kosovës prej pas luftës dhe vazhdojnë edhe me tutje ta mbështesin përmes IADK.

Misionit të IADK janë duke ndihmuar fermerët përfitues të cilët kanë marrin guximin që të hyjnë në projekte të reja pilote dhe orgnaizimin e tyre instrucional përmes shoqatave dhe union të shoqatave, të cilët me besnikëri janë duke aplikuar këshillat e ekspertëve të IADK-së.

Ju jemi mirënjohës dhe i falemindrojmë donatorët EED, FCA, LWF partneret, si dhe të gjithë përfituesve të programit të IADK të cilët janë duke kontribuar në zhvillimin e bujqësisë në regjion dhe Kosovës.

Zenel Bunjaku Drejtor Ekzekutiv

Raport vjetor 2009

Mbeshtetur nga:

- FinChurcAid/Government of Finland (FCA/GoF)
- Evangelischer Entwicklungsdienst, Germany (EED)
- Lutheran World Federation (LWF)
- DANDAT

Shtritrja e aktiviteteve: Komunitet Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Zveçan, dhe Zubin Potok

Fokusimi i aktiviteteve:

- Përmirësimi i gjendjes në blegtori, bletari, pemë dhe perime në zonat rurale të regjionit të Mitrovicës përmes mbështetjes me inpute, mekanizim dhe aplikim të praktikave të mira të punës
- Fuqizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve institucionale të fermerëve në Kosovë
- Ngritja e kapaciteteve individuale dhe grupore të fermerëve përmes trajnimeve, këshillave, vizitave dhe publikimeve
- Mbështetja e rasteve sociale

Përfituesit direkt:

- 124 Familje kanë përfituar,** Impute bujqësore për kultivim të fidanëve të perimeve, kornishonit, mekanizim bujqësorë për pemë, pajisje për bletari, mëshqerra mbarrëse, pula vojse dhe ushqim të koncentruar
- 201 Fermer, Zyrtarë komunal për bujqësi dhe staf i IADK-së,** kanë marrë pjesë në 16 vizita: Kosovë (3) Maqedoni (2), Shqipëri (3) Mali i Zi (1), Bosnje e Hercegovinë (1), Kroaci (1), Slloveni (2), Suedi (1), Holandë (1) dhe France (1)
- 968 Fermer,** kanë marrë pjesë në 72 sesione të trajnimeve
- 4 Module të trajnimeve përpunim shtëpiak,** 88 ditë trajnime për 98 gra të certifikuar: Përpunim i qumështit, Përpunim i pemëve dhe Përpunim i perimeve
- 5 Panaire dhe ditë fushore,** 216 pjesëmarrës
- 1 Publikim praktik,** një broshurë 1000 kopje
- 3 Partnerë ndërkombëtarë,** Mercy Corps, AFDI, PUM
-

Sigurimi i makinave për anëtarë të Shoqatave të Fermeve (ShF)

Për 6 anëtarë të Shoqatave të Fermerëve (ShF) pemëtar „Frutikultura” Vushtrri dhe „Pemishtja” Skenderaj janë shpërndarë 6 makina bashkëkohore, dy **Rotofreza** dhe katër **Atomizer**. E veçantë e makinave është se janë risi në regjionin e Mitrovicës.

Atomizeret janë me kapacitet 340L dhe janë të destinuar për spërkatje të pemishteve ndërsa freza është e destinuar për mihjen e tokës në rende të pemëve dhe janë të pajisur me sensor automatik.

Të gjithë përfituesit kanë marrë edhe nga një manual për përdorimin e makinave së bashku me listën e fermerëve anëtar të shoqatave, kushtet e pagesës së shërbimit për anëtarët e shoqatave (70%) dhe jo anëtarët (100%) nga vlera e tregut për shërbime të ngjashme. Përfituesit kanë ndjekur edhe trajnimin për përdorimin e pajisjeve. IADK ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me fermerët përfitues dhe makinave, përdorimi më i madh i roto frezës është bërë në fund të vegjetacionit. Përveç përfituesit të makinave shërbime kanë marrë edhe anëtar të tjerë të FA. Deri me tani roto frezën e kanë përdorur edhe 6 Fermer nga komuna e Skenderajt dhe 7 Fermer nga komuna e Vushtrrisë, ndërsa Atomizerët janë përdorur më tepër gjatë vegjetacionit dhe deri me tani është përdorur nga 9 fermer në komuna e Vushtrrisë dhe 7 fermer komuna e Skenderajt.

Dy atomizer janë të shpërndarë në dhjetor nga buxheti i kursimeve dhe përdorimin e tyre do të fillojnë ta bëjnë gjatë vitit 2010.

Furnizimi i FA me këto makina ka ndikuar në :

- Intensifikimin e bashkëpunimit mes IADK-së me fermer dhe në mes fermerëve anëtarëve të FA
- Efikasiteti në mbrojtjen e pemëve nga dëmtuesit dhe sëmundjet është shtuar në masë më të madhe me rreth 70% në krahasim me metodat paraprake
- Fermerët ndjehen me të sigurt në përdorimin e pesticideve
- Është zvogëluar kostoja e shfrytëzimit të pesticideve (tani nuk përdoren herbicide)
- Kultivimi i tokës nëpër rende është më i shpejt dhe më kualitativ

- Janë krijuar mundësi më të mira në mirëmbajtjen e tokës mes rendeve e që lehtëson edhe kryerjen e punëve tjera në pemishte.



Pajisje dhe makina për bletar

Është arritur të mbështetën 23 bletarë me nga një pako të pajisjeve cilësore (inox): Hapëse hojesh, Centrifug radiale elektrike, shkrirëse e dyllit me gaz dhe mbushëse e kavanozave kapacitet 50 L .

IADK ne bashkëpunim me shoqatat e bletareve (SHB) “POLENI” dhe “APICANTER” nga Mitrovica, “EMA” nga Vushtrria, “DRAMIQARJA” Skenderajt me përfaqësues si dhe me përfaqësues të Departamenteve Komunale për bujqësisë të komunave përkatëse ka bërë identifikimi i bletareve.

Kriteret bazë për të qenë përfitues kanë qenë: të jenë anëtar të shoqatave të bletareve, të kenë mbi 20 shoqëri bletësh, të kenë vend të mjaftueshëm për mbajtjen e bletëve si dhe të kenë traditë në mbajtjen e bletëve.

Ne baze të vizitave që janë bërë 23 përfituesve bletarë po japim disa të dhëna mbi rendimentet e arritura në prodhime të ndryshme të bletës.

Përfitimet e 23 përfituesve sipas llojit të prodhimitarisë të bletës

Nr	Lloji	Prodhimi kg	Çmimi €/kg	Vlera Euro
1	Mjalte	16280	9	146,520.00
2	Dyll	1092	4.5	4,914.00
3	Polen	74	30	2,220.00
4	Propolis	38	55	2,095.00
5	Qumsht blete	0.730	5000	3,650.00
Total				159,399.00

Pajisjet që i kanë përfitur bletarët kanë rezultuar në uljen e kostos së prodhimit të mjaltit, në bazë të deklarimeve të bletarëve del se me pajisjet të cilat bletarët i kanë përdorur në bletoret e tyre rreth 80 % e punëve janë kryer me shpejt. Gjithashtu në mënyrë të ndjeshme është përmirësuar edhe higjiena dhe cilësia e prodhimeve të bletës në veçanti të mjaltit dhe e dyllit.

Furnizimi i prodhuesve të materialit fidanor të perimeve me farëra dhe impute bujqësore

Janë përkrahur 11 përfitues prodhues të fidanëve të perimeve me nga një pako e cila ka përfshirë: Module për prodhim të fidanëve substrat për prodhim të fidanëve pako të preparateve, farë të hibrideve të domates specit dhe trangullit. Përzgjedhja e përfituesve është bërë në bashkëpunim me shoqatat e fermerëve prodhues të perimeve dhe departamentet komunale për bujqësi në komunat Vushtrri, Skenderaj, Mitrovicë dhe me Zyrën Lokale të komuniteteve në fshati Qabër komuna e Zubin Potokut.

Nga ky projekt kanë pas rast të përfitojnë edhe përfituesit e serrave të IADK-së nga vitet e kaluara të cilët i kanë blerë fidanët e perimeve me një çmim 30% më të ulët.

Prodhuesit e fidanëve një pjesë të fidanëve të perimeve e kanë përdorë për nevojat e veta ndërsa pjesën tjetër i kanë shitur fermerëve tjerë

Rezultatet e arritura nga ky pilot projekt:

- Te speci është shkurtuar koha e prodhimit të një fidani për një muaj.
- Duke pas parasysh temperaturat e dimrit në masë të madhe janë ulë edhe shpenzimet.
- Fidanët e prodhuara sipas kritereve të rekomanduara pas një madhësi optimale, potencial gjenetik për prodhimtari dhe cilësi të lartë, të pastra nga sëmundjet dhe dëmtuesit.
- Rendimentet në raport me prodhimtarinë tradicionale kanë qenë 2-3 herë më të larta
- Është rritur në mënyrë të ndjeshme interesimi i fermerëve për të shfrytëzuar këtë mënyrë të prodhimtarisë së fidanëve dhe perimeve



Pilot – Projekti kultivimi i trangullit kornishon në formë shpalim

Si një pilot projekt me një metodologji të kultivimit ndër të parat në Kosovë ka zgjuar interesimin e fermerëve në mënyrë të kënaqshme. Për këtë projekt kanë shprehur interesim një numër i konsiderueshëm i fermerëve prej të cilëve janë zgjedhur 15 përfitues. Përzgjedhja e përfituesve është bërë në bashkëpunim me shoqatat e fermerëve prodhues të perimeve dhe departamentet komunale për bujqësi në komunat Vushtrri, Mitrovicë dhe me Zyrën Lokale të komuniteteve në fshati Qabër komuna e Zubin Potokut.

Secili përfitues i 1000m² të sipërfaqes me kornishon ka pranuar fara hibride të kornishonit, sistemin e ujitjes pika-pikë dhe folinë e zezë

plastike për 10 ari, pleh mineral NPK, pleh kristalorë, një pako të pesticideve, një pompë spërkaste CP3 prej 20 L.

Për të gjithë përfituesit është përgatitur edhe nga një udhëzues praktik për mënyrën e kultivimit të trangullit kornishon..

Duke filluar nga 10-25 Korrik është kryer mbjellja e farave të trangullit, vjelja ka filluar 20 gushtit dhe ka mbaruar me 11 tetor. Rendimentet mesatare kanë arritur 2160kg/1000m² ndërsa ato më të larta mbi 4000 kg/1000m². Çmimi mesatar i shitjes ka qenë 0.56€/kg. Të hyrat mesatare për një fermer kanë qenë 1200€.

Muaji	Vjelja sipas hibrideve				Çmimi mes. i shitjes €/kg	Shitja totale €/kg	Konsumi familjar /kg
	Bereg	ZKI 807	ZKI 104	Total			
Gusht	2347	387	465.5	3199.5	0.55	1753.2	54
Shtator	18829	1935	2263	23027	0.54	12380.15	651
Tetor	4950	738	490	6178	0.63	3914.5	400
Total	26126	3060	3218.5	32405	0.56	18047.85	1105
Të hyrat mes. për përfitues	1742	204	214.57	2160.3	0.56	1203.19	73.67

Të arriturat:

- Ky projekt pilot ka qenë një përvojë mjaft të mirë për fermerët por edhe për profesionistët e bujqësisë
- Disa rendimentet mbi 4000 kg/1000m² janë mjaftë inkurajuese
- Është nxjerrë një përfundim i kartë mbi adaptimin e tri hibrideve të kornishonit në kushtet e regjionit të Mitrovicës
- Është arrit në masë të madhe të furnizohet tregu gjatë periudhes Gusht-Tetor
- Është dëshmuar se kornishoni është një alternativë mjaftë e mirë edhe si kulturë e dytë në veqanti pas tërshërës së gjelbër
- Është rritur interesimi i fermerëve për këtë kulturë



Shperndarja e pulave vosje dhe koncentratit

Mbështetja e 11 rasteve sociale - fshati Klladrenicë komuna e Skenderajt
Të gjitha familjet janë mbështetur me nga 50 pula vojse 18 javësh dhe 160 kg koncentrat ndërsa 9 prej tyre janë mbështetur edhe me kotec për pula.

Përzgjedhja është bërë në bashkëpunim me KFOR-in Danez, Departamentet për Bujqësi dhe Çështje Sociale të komunës së Skenderajt.

Mbështetja e 23 rasteve në enklava (15 familje serbe dhe 8 shqiptare) – në fshatrat Gracë (8), Banjskë (1 komuna e Vushtrrisë), Bajë (4), Suhogërl (2), komuna e Skenderajt Qabër (3), komuna e Z. Potokut, Zhazhë (2), Boletin (2), komuna e Zveqanit, Vllahi (1) komuna e Mitrovicës. Përzgjedhja e përfituesve është bërë në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve.

Secili përfitues ka përfitua 120 zogëza 18 javësh dhe nga 800 kg koncentrat. Prodhimtaria e vezve ka filluar të gjitha pulat dhe sipas kushteve që përfituesit ju kanë ofruar pulave prodhimtaria e vezëve e sillet prej 55 deri në 90 %. Momentalisht përfituesit e pulave kanë filluar edhe me shitjen e vezëve ku kryesisht shitjen e vezëve është duke e bërë direkt në ferme dhe një pjesë tek të afërmit e tyre në fshat. Të hyrat mesatare mujore për një familje me përqindje të vojshmerisë 85 % sillet diku 210 Euro në muaj.

Të arriturat:

- Është zbutur sado pak gjendja ekonomike e një numri të familjeve me kushte të rënda sociale dhe e atyre që jetojnë në enklava
- Është përhapur një ndjenë mirëkuptimi në mes komuniteteve
- Ka pas një bashkëpunim të mirë me të dy komunitetet në implementimin e projektit



Mëshqerra mbarrëse të racës (70 krer)

Duke u njohur me nevojat dhe kërkesat e fermerëve për lope qumështore IADK ka vendosur që te importohen lope te racës qumështore Red Holstain. Nga ky projekt kanë përfituar 35 fermer nga dy mëshqerra mbarrëse të racës Red Holstain dhe shërbim veterinar. Përzgjedhja e përfituesve është bërë në bashkëpunim me shoqatat e fermerëve prodhues të qumështit dhe departamentet komunale për bujqësi në komunat Vushtrri, Skenderaj dhe Mitrovicë. Për përzgjedhjen e përfituesve është përdorur sistemi i poentimit ku prioritet i është dhënë rasteve që kanë plotësuar më së miri këto kriterë:

- Fermerët te cilët dorëzojnë qumësht ne pikat grumbulluese te cilat i ka themeluar IADK
- Anëtarët e shoqatave te cilat veprojnë ne regjionin e Mitrovicës
- Fermerët te cilët kane zbatuar ne mase te madhe këshillat dhe te cilët janë kooperative me stafin e IADK.
- Fermerët te cilët kane kapacitet për mbajtjen e lopëve sa i përket hapësirës se fermës dhe ushqimit.

Importi i mëshqerrave mbarëse është bërë sipas të gjitha standardeve ligjore duke ju nënshtruar karantinës dhe testeve të analizave. Gjithashtu para se te behet shpërndarja e mëshqtjerrave IADK ka angazhuar një veterinarë për ta bere kontrollimin e lopëve dhe verifikimin e mbarsmërisë së tyre.

Shperndarja e mëshqerrave ëshë bërë gjatë muajit tetorë dhe nëntorë. Gjatë kësaj periudhe të fund të vitit kane pjellë 61 mëshqtjerra prej tyre 31 viça janë femra 30 meshkuj ndërsa deri me tani kane ndodhur 3 mëshqerra dhe kanë abortuar 6 mëshqerra. Sa i përket prodhimtarisë se qumështit, ne baze te raporteve qe i kemi marre nga fermerët mëshqtjerrat e te cilëve kane pjellur është e mire dhe fermerët janë shume te kënaqur, ku mesatarja e prodhimtarisë se qumështit për muajin e pare te laktacionit është 15 litra qumësht ne dite.

Të arriturat :

- Shpërndarja për herë të parë e një race Qumështore (Red holstein) në regjionin e Mitroviës
- Ngritja e prodhimtarisë së qumështit
- Fillimi i përmirësimit të strukturës së racës së lopëve qumështore
- Përmirësimi i të ardhurave i familjeve që merren me prodhimin dhe shitjen e qumështit.
- Forcimi i shoqatave të fermerëve përmes mbështetjes së anëtarëve të tyre



Edukim i fermerëve

- 1. Promovimi i aktiviteteve me gra në zonat rurale - përpunimet shtëpiake**
- 2. Organizim i fermerëve**
- 3. Vizitat**
- 4. PanaiRET**
- 5. Trainimet**
- 6. Publikimet**
- 7. Aktivitete me partnerë profesional internacional**

Promovimi i aktiviteteve me gra në zonat rurale - përpunimet shtëpiake

Fillimisht në komunat Vushtri dhe Skenderaj është bërë promovimi i projektit ku është planifikuar implementimi i këtij aktiviteti. Është arritë që në vitin 2009 të zhvillohen tri module: “Përpunimi shtëpiak i qumështit”, “Përpunimi shtëpiak i pemëve” dhe “Përpunimi dhe konservimi shtëpiak i perimeve”. Në bashkëpunim me Mercy Corps-in është zhvilluar edhe një modul në Malishevë “Përpunimi i kumbullës”

Si kriter bazë për përcaktimin e vendeve për mbajtjen e këtyre moduleve ka qenë përzgjedhja e zonave rurale ku ka traditë në prodhimin e qumështit, kultivimin e pemëve dhe perimeve.

Moduli i qumështit - Si pika referuese kanë qenë Pika Grumbulluse të qumështit (PGQ) të cilat janë krijuar me mbështetjen e IADK-së. Pas promovimit janë përzgjedhë 4 PGQ (Smrekonicë, Novalan, Bajskë dhe Stanovc në komunën e Vushtrrisë) me të cilat është punuar në përzgjedhjen e kandidateve. Edhe pse planifikimi ka qenë të formohet një grup prej 15-18 kandidateve por pas një interesimi të madh janë formuar 2 grupe “Grupi i Smrekonicës 13 kandidate” dhe “Grupi i Stanovcit 14 kandidate” Para fillimit të modulit me të gjitha kandidatet është mbajtur një prezantim për tu njoftuar me programin. Programi i modulit të qumështit ka pas një fond prej 20 ditë pune të cilat 70% kanë

qenë praktikë dhe 30% teori. Kandidatet gjithashtu i janë nënshtruar një testi për verifikimin e njohurive të arritura të cilat me sukses e kanë përfunduar. Ndërsa në fund të gjitha kandidatet janë Certifikuar për përgatitjen e 13 llojeve të djathit. Pas Certifikimit në Mitrovicë është organizuar një promovim publik i produkteve të djathit nga të gjitha kandidatët. Në këtë promovim kanë marrë pjesë institucione të ndryshme, organizata, mediat nacionale dhe lokale si dhe qytetar.



Moduli i pemëve - Është mbajtur në fshatin Pemishte komuna e Skenderajt prej datës 18.05.2009 deri 07.08.2009. Në këtë cikël të trajnimeve kanë marrë pjesë 21 kandidate nga 4 fshatra. Janë zhvilluar 30 ditë trajnime teorike dhe praktike 30 % ka qenë teori kurse 70 % praktikë. Në fund të ciklit të trajnimeve të gjitha kandidatet i janë nënshtruar një testi për verifikimin e njohurive të arritura të cilat me sukses e kanë përfunduar. Pas përfundimit të suksesshëm të testit pjesëmarrëset janë Certifikuar në një ditë ceremoniale ku është organizuar një promovim publik i produkteve të përpunuara nga gratë pjesëmarrëse. Në këtë ditë kanë marrë pjesë institucione të ndryshme, organizata dhe qytetar.



Moduli i perimeve - Është mbajtur në fshatin Shtitaricë komuna e Vushtrrisë prej datës 01.09.2009 deri 30.10.2009. Në këtë cikël të trajnimeve kanë marrë pjesë 34 candidate të ndara në dy grupe nga 5 fshatra.

Edhe ky modul ka pas 30 ditë trajnime teorike dhe praktike, 30 % teori kurse 70 % praktikë. Gjithashtu në fund të ciklit të trajnimeve të gjitha kandidatet i janë nënshtruar një testi për verifikimin e njohurive të arritura të cilat me sukses e kanë përfunduar. Pas përfundimit të suksesshëm të testit pjesëmarrëset janë Certifikuar në një ditë ceremoniale ku është organizuar një promovim publik i produkteve të përpunuara nga gratë pjesëmarrëse. Edhe në këtë ditë promovuese kanë marrë pjesë një numër i madh i njerëzve nga institucione të ndryshme, organizata dhe qytetar.



Moduli i kumbullës - Është mbajtur në fshatrat Carallugë dhe Gurbardhë komuna e Malishevës gjatë muajit Shtator. Në këtë cikël të trajnimeve prej 8 ditësh kanë marrë pjesë 16 kandidate të ndara në dy grupe. Puna me grupe gjithashtu ka qenë praktike dhe teorike dhe të gjitha pjesëmarrëset kanë arritë që të certifikohen.



Të arriturat:

- Është arritur që të aftësohen dhe certifikohen 98 gra : 27 gra për përgatitjen e 13 llojeve të djathit, 37 gra për përgatitjen e 16 llojeve të përpunimeve shtëpiake të pemëve, 34 gra për përgatitjen e 18 llojeve të përpunimeve shtëpiake dhe konservimeve të perimeve
- Është arrit që pas certifikimit në të gjitha modulet të realizohet nga një promovim publik shumë i suksesshëm i produkteve të të përpunuara gjatë moduleve.
- Është arrit që me këto përpunime gratë të gjejnë tregje të reja për prodhimet e tyre në ato të qumështit
- Është arrit që gratë e Certifikuara me përpunimet e tyre të prezantojnë edhe në një panair kombëtarë të prodhimeve bujqësore që është mbajt në Prishtinë

Organizim i fermerëve

Fillimisht janë kontaktuar të gjitha organizatat bujqësore (shoqata dhe kooperativa) të cilat kanë statut legal dhe veprojnë në regjionin e

Mitrovicës. Bashkërisht me këto organizata është biseduar edhe për iniciativat e më hershme të fermerëve dhe mundësinë që IADK përmes projektit të EED-së ta mbështes formimin e një Unioni të fermerëve. Nga 20 organizata kësaj iniciative ju kanë përgjigjur pozitivisht 17 prej tyre të cilat edhe i kanë propozuar kandidatët për formimin e rrjetit të fermerëve.

Gjatë periudhes një vjeçare janë mbajtur trajnimeve në:

- Aspekte legale mbi themelimin e Unionit të Fermerëve
- Trajnime mbi ngritjen e njohurive menaxhuese të organizatave

Për secilin grup të trainimive janë zhvilluar nga 4 ditë trajnime gjithsej 8 trajnime me tema përkatëse

Pas zgjedhjes së organeve të kryesisë së Unionit është nënshkruar një kontratë me kryetarin e USHFRM-së me qëllim që të vazhdohet me procedurat e regjistrimit të shoqatës

Të arriturat:

- Është arrit që fermerët ta kuptojnë rëndësinë e fuqizimit të tyre përmes krijimit të organizatave më të fuqishme
 - Krijimi i një vizioni dhe një misioni të qartë për **“Unioni i Shoqatave të Fermerëve në Regjionin e Mitrovicës”**
 - Janë krijuar organet drejtuese të këtij Unioni
 - Është arrit që fermerët ta kuptojnë rëndësinë e përfaqësimit, lobimit dhe advokimit të fermerëve dhe njohja me disa përvoja të lobimit dhe advokimit të fermerëve në Francë
 - Së bashku me anëtarët e USHFRM-së është arritur që të përpilohet koncepti i Statutit të organizatës
 - Është arrit që fermerët të krijojnë një koncept për përpilimin e Planit strategjik
 - Gjithashtu është arrit të krijohet një vizion për përpilimin e projekteve dhe marketingun e prodhimeve bujqësore
-

- Të kuptohet rëndësia e sigurimit të këshillave të përbashkëta si dhe qasjen në sigurimin e fondeve për zhvillim të fermerëve



Vizitat

Janë realizuar 15 vizita: në Kosovë (3) Maqedoni (2), Shqipëri (2) Mali i Zi (1), Bosnje e Hercegovinë (1), Kroaci (1), Slloveni (2), Suedi (1) Holandë (1), France (1) kanë marrë pjesë fermer, Zyrtarë komunal për bujqësi dhe staf i IADK-së



Këto vizita kanë pasë për karakter këmbimin e përvojave, njohjen me përvoja të reja si dhe pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme me karakter zhvillimor të bujqësisë.

Nr.	Vendi	Data	Nr.i pjesama.	Agjenda
1.	Kosovë (Pejë, Krushë e madhe)	21.05.09	28	Përpunim i qumështit dhe perimeve
2.	Kosovë (Deqan)	09.10.09	14	Pemëtari
3	Kosovë (Gjakovë, Krushë e Madhe)	03.11.09	41	Përpunim i pemëve dhe perimeve
4	Maqedoni (Shkup, Koqan, Manastir, Gostivar)	28-30.05.09	8	Organizim i fermerve
5	Maqedoni (Gostivarë, Tetovë)	03-06.12.09	8	Blegtori, Prodhimtari e qumështit
6	Shqipëri (Tiranë)	27-30.01.09	1	BAAN
7	Shqipëri (Tiranë, Korqë)	25-28.09.09	10	Pemëtari, Prodhimtari e mollës
8	Mal të zi	14-15.11.09	1	"Mian Principals of IPARD programming"
9	Bosnje	8-11.06.09	1	BAAN
10	Kroaci	12-13	1	Agriculture and Elargement
11	Slloveni	3-4.09.09	1	The role of Agriculture NGO in defining agriculture policy
12	Slloveni	06.09.09	1	Enlargement and Avenues for Coopertion
13	Suedi	21-26.04.09	1	BAAN
14	Holandë	21-27.06.09	2	Hortikulturë - Prodhimtari e pemëve dhe perimeve
15	Francë	10-22.12.09	5	Blegtori – Prodhimtari e qumështit

Panaire

Është organizuar një ditë fushore, janë vizituar dy panaire si dhe kemi marrë pjesë me eksponate në një panair dhe në një ditë fushore.

“Dita e dredhës” Skenderaj 2009 (05.06.2009)

Në këtë promovim kanë qenë të evidentuar 136 pjesëmarrës të ftuar si dhe një numër i madh i qytetarëve. Në kuadër të pjesëmarrësve kanë qenë Zëvendës ministri i MBPZHR, Profesor nga Universiteti i Prishtinës dhe Tiranës, Përfaqësues të institucioneve të ndryshme komunale, Zyra Finlandeze, KFOR-it, shoqatat ndryshme, fermerë etj.

Agjenda e këtij takimi ka qenë:

Pjesa e parë në sallë - IADK ka prezantuar rezultatet të arriturat dhe përvojën në kultivimin e dredhës si dhe është zhvilluar një debat nga të pranishmit dhe stafit të IADK-ës për mënyrën e kultivimit dhe zgjerimi i sipërfaqeve me këtë kulturë

Pjesa e dytë në ekspozitë -Vizitë e ekspozimeve të dredhës nga disa prodhues të regjionit të Mitrovicës, dhe zgjedhja e kultivarëve më të mirë të dredhës për vitin 2009

Komisioni për vlerësimin e kultivarëve është formuar nga 9 anëtarë: përfaqësues nga Fakulteti i Bujqësisë Prishtinës dhe Tiranës, Ministria e Bujqësisë, Komunitat, Organizata jo qeveritare, fermer dhe konsumator Komisioni ka përdorur kritere standarde të vlerësimit. Sipas vlerësimit të komisionit për nga cilësia janë radhitur: Alba, Azia, Dora, Maya dhe Roxana.

Të arriturat :

- Pasqyrimi i një pune dhe përvoje të mirë dhe të gjatë në kultivimin e dredhës të bërë nga IADK dhe fermerët e regjionit të Mitrovicës
 - Motivimi i fermerëve për punë të më tejme në kultivimin e dredhës
 - Njohja më e mirë e konsumatorit me prodhimin vendor dredhës dhe cilësinë e sajë
 - Dhënia e një vlerësimi profesional për kultivarët e dredhës që kultivohen në Regjionin e Mitrovicës Kosovës dhe formimi i një rang liste për kultivarët me të preferuar të dredhës për Kosovë
-

- Prezantimi në ekspozitë edhe të një numri të përpunimeve të dredhëzës 1të bëra nga gratë të trajnuara përmes programeve të IADK-së



Vizita e panairit të Agrobiznesit Tirana 2009 (24-27.09.2009)- Në këtë vizitë kanë marrë pjesë 50 pjesmarrës kryesisht fermerë të IADDK-së. Pjesëmarrësit kanë qenë të Regjionit të Mitrovicës prej të cilëve 9 blegtor, 10 pemëtar, 8 perimtar, 6 bletar, 10 gra nga grupi i grave prodhuese të djathit pemeve dhe perimeve 4 zyrtare të komunave dhe 3 nga stafii i IADK-së.

Vizitë e panairit ndërkombëtarë të ushqimit dhe pijeve Shkodra 2009 – Është mbajtur 14-16.05.2009 në Shkodër. Këtë panair e kanë vizituar dy fermer pemëtarë dhe një staf i IADK-së.

Pjesëmarrja në ditën fushore të mollës Kovraga 2009. Është mbajtur me datë 23.09.2009 në Kovragë të Istogut. Në këtë ditë kanë marrë pjesë edhe 9 fermer të IADK-së prodhues të mollës të cilët kanë ekspozuar kultivarë të ndryshëm të mollës.

Panairi i produkteve bujqësore Prishtina 2009 – Është mbajtur prej 13-16 Tetor. Në këtë panair kanë marrë pjesë 18 përfitues të projektit nga IADK prej të cilëve 13 kanë ekspozuar prodhime (djathë, molla, perime, përpunime të pemëve dhe perimeve).




Trainimet

Kjo komponentë ka qenë pjesë kyqe e aktiviteteve të IADK-së në kuadër të mbështetjes profesionale dhe ngritjes së njohurive të fermerëve gjatë vitit 2009. Kjo formë e mbështetjes është realizuar në forma të ndryshme si: trajnimeve në sallë trajnimeve në fermë, këshillimeve në fermë, këshillimeve në zyrë dhe këshillimeve përmes telefonit. Vetëm në formë të trajnimeve të organizuara janë regjistruar 960 pjesëmarrës ndërsa numri i atyre që kanë marrë këshilla në forma individuale qoftë në fermë, zyre ose përmes telefonit ka qenë mbi 1000.

Publikimet

Është publikuar broshura “ Përpunimi shtëpiak i pemëve, perimeve dhe qumështit” e cila i ka përmbledhë materialet dhe punën praktike me grupet e grave në tri modulet (qumështit, pemëve dhe perimeve). Kjo broshurë është publikuar në 1000 kopje Kërkesat për këtë broshurë janë mjaft të mëdha dhe deri më tani janë shpërnda 259 kopje.



Aktivitete me partnerë profesional inernacional

Mercy Corps - Janë realizuar dy aktivitete të përbashkëta:

- Organizimi i një cikli prej 30 trajnimeve për mollën me shoqatatë e pemëve “Frutikultura” nga Vushtri dhe “Pemishtja” nga Skenderaj
- Moduli i përpunimit të kubullës një cikël prej 7 ditësh me një grup të grave në komunën e malishevës.



AFDI nga Franca Kjo është një organizatë ndërkombëtare e fermerëve me seli në Normandi të ulët në Francë. Me këtë organizatë IADK ka nënshkruar një “Memorandum Bashkëpunimit” për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të këmbimit të përvojave dhe ngritjen profesionale të fermerëve në veçanti ata të blegtorisë. Gjatë këtij viti janë realizuar dy misione 7 ditore në Kosovë nga tre përfaqësues të AFD-it (një në Prill dhe një në Shtatorë), një student nga Franca ka pasë dy misione në Maj dhe në Shtator deri Tetor. Një grup prej 5 vetave (një staf i IADK-së tre fermer dhe një zyrtarë komunal) kanë qëndruar 12 ditë në Francë në muajin dhjetorë.

Qëllimi i të gjitha aktiviteteve ka qenë përmirësimi dhe ngritja e prodhimtarisë së qumështit dhe motivimi i organizatave të fermerëve.



PUM Netherlands Senior Experts - Si rezultat i një bashkëpunimi të suksesshëm me organizatën (PUM) është arritur që të organizohet një vizitë 7 ditore (Mars) e një eksperti të dredhës nga Holanda në Kosovë – IADK. Gjatë qershorit dy persona nga stafi i IADK-së kanë qenë në një vizite studimore 7 ditore në Holandë.

Këto aktivitete kanë pasë për qëllim njohjen me përvoja të reja në lëmin hortikulturës në veçanti pemëve dhe perimeve.



Ngritja e kapaciteteve të IADK-së

Trajnimet - me qëllim të ngritjes së kapacitetit të stafit të IADK-së për 7 persona nga ky stafi janë organizuar kurse përkatëse të gjuhës angleze. Kurset janë në vijim e sipër.

Marrja eksperiencës nga IADK

Dy student nga Universiteti I Prishtinës dhe një nga Anglia dhe një nga Franca (4 student) kanë përfunduar kurset e praktikantëve ne IADK

Website - Është arritur që në aspektin teknik Websaiti i IADK-së www.iadk.org të jetë funksional. Mirëpo edhe pse është filluar me vendosjen e disa të dhënave ka pas vështirsi në mirëmbajtjen dhe vendosjen e vazhdueshme të dhënave nga stafi i IADK-së. Pengesa kryesor ka qenë se kjo punë ka qenë risi për stafin dhe ka kërkuar kohë për përpunimin dhe vendosjen e të dhënave. Për këtë qëllim është parapa që në të ardhmen të shihet mundësia e mirëmbajtjes nga kompania që e ka krijuar Websaitin.

Tregim i nga Avni Kurti

Është 23 vjeçar, jeton në fshatin Qabër komuna e Zubin Potokut bashkë me familjen shat anëtarësh, prindërit vëllezërit dhe motrat e tij.



Ngjarjet e luftës i kishte përjetuar në një moshë shumë të re 12 vjeçare në kohën kur ishin ç’vendosur i tërë fshati dhe të gjitha shtëpitë ishin djegur ose rrënuar. Pas mbarimit të luftës familja e tij por edhe fshati në përgjithësi ishte ndihmuar në rindërtimin e shtëpive të shkatërruara. Avniu së bashku me familjen

e tij me pa durim kishte pritur kthimin në vendlindjen dhe tokën e tij. Pas kthimit ai vazhdoi shkollimin dhe me sukses e ka përfunduar shkollën e mesme Ekonomike. Tani së bashku me familje punojnë rreth 2 ha tokë, 0.6 ha i kanë në pronësi dhe 1.5 ha me qira. Kryesisht merren me kultivimin e perimeve spec, domate, qepë dhe patates.

Deri në vitin 2009 nuk kishin marrë asnjë mbështetje në aktivitetet e tyre në bujqësi nga asnjë donatorë. Në ndërkohë Avniu kishte dëgjuar për Organizatën IADK e cila kishte mbështetur shumë fermer në regionin e Mitrovicës por edhe në fshatin e tij Qabër dhe menjëherë ishte paraqitë në zyrën e sajë në Mitrovicë. Aty ishte njoftuar për Pilot projektin për trangullin kornishon, për të cilin ai kishte shfaqur menjëherë interesim. Edhe pse parcela kishte një pozitë kodrinore jo aq të përshtatshme komisioni profesional për vlerësimin e kandidatëve duke e par entuziazmin dhe interesimin e lartë të Avniut për kishte vendosur që ta mbështesë atë. Me këtë rast ai kishte përfituar pakon për kultivimin e 1000 m² të trangullit kornishon në fushë të hapur “Sistemi Shpalir”. Kjo pako përfshinte: fara hibride të trangullit kornishon, sistemin e ujitjes pika-pikë, folinë e zezë plastike, 100 kg pleh mineral NPK, 25 kg pleh kristalorë, një pako të pesticideve, dhe një pompë spërkaste prej 20 L.



Avniu pas përzgjedhjes së tij në mesin e 15 përfituesve në regjionin e Mitrovicës me përpikëri i ka ndjekur të gjitha trajnimet dhe këshillat profesionale të dhëna nga stafi i IADK-së. Bazuar në këtë dhe në punën e palodhshme të tij me familje ka arrit që të jetë një prej fermerëve më të suksesshëm.

Kështu që brenda një periudhe vegjetative tre mujore fillimi i Korrikut - fillimi i Tetorit, ka arrit ti vjelë dhe ti shesë rreth 4100 kg trangull me çmim mesatar 0.57 €/kg ose rreth 2300 €/1000 m².

Ky projekt për Avniun ka qenë një përvojë e re shumë e mirë ku ka arrit rezultate të larta si dhe ka fituar njohuri të cilat do ti ndihmojnë në vazhdimin dhe zgjerimin e këtij aktiviteti edhe në të ardhmen.

Avniu është shumë mirënjohës ndaj organizatës IADK dhe stafit profesional të saj për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme e cila ka bërë që ai ta ndjej veten më të sigurt në fermën e tij

Tregim nga Sadete Hasani

Është 48 vjeçare, jeton në fshatin Bajskë komuna e Vushtrris bashkë me me burrin dhe 11 anëtarë tjerë të familjes.

Familja ka një traditë për tu marrë me bujqësi e cila ka edhe një fermë prej 12 krerëve të lopëve qumështore. Ferma është burimi kryesor i sigurimit të ardhurave për familje. Familja e saj në vitin 2006 ka përfitua 2 lopë nga programi i bujqësisë. Qumështin e prodhuar nga ferma e tyre fillimisht e kanë dorëzuar në Pikat Grumbulluese të Qumështit (PGQ) të themeluara nga IADK në fshatrat Bajskë dhe Smrekonicë komuna e Vushtrrisë.

Gjatë vitit 2009 IADK kishte një program për aftësimin e grave në përpunimin shtëpiak të qumështit, pemëve dhe perimeve. Në kuadër të përpunimit të qumështit janë përfshi kryesisht gratë e fermerëve që dorëzojnë qumësht në PGQ të ngritura nga IADK. Në mesin e 27 grave të cilat kanë ndjekur një modul të trajnimeve prej 20 ditëve ka qenë edhe Sadetja. Pas këtyre trajnimeve të gjitha kandidatet janë certifikuar. Kjo Certifikatë për të gjitha këto kandidate e në veçanti për Sadeten nuk ka qenë vetëm një letër por një dëshmi reale e arritjes së njohurive praktike dhe teorike. Këto njohuri i ka jetësuar duke e përpunuar qumështin dhe gjetjen e tregut për përpunimet e saj. Sipas Sadetës këto njohuri ishin një shpëtim për fermën e sajë kur nga muaji Maj deri në Shtator të gjitha Qumështoret kishin ndërprerë grumbullimin e qumështit nga pjesa dërmuese e PGQ. Gjatë kësaj kohe qumështin që e dorëzonte në PGQ filloj ta përpunoj dhe të gjej një treg. Kërkesat për përpunimet e saj për çdo ditë rriteshin dhe tani Sadetja ka klientët e saj në Mitrovicë, Vushtrri, Prishtinë e deri në Gjiilan.



Tani një pjesë të qumështit nga ferma e saj e dorëzon në qumështoren Aldi në Mitrovicë dhe pjesën tjetër e shet në formë të përpunuar në djathëra të ndryshme 150 – 200 kg në muaj me një çmim mesatar 3€ / kg.

Sadeti për të ardhmen mendon me rritë numrin e lopëve gjithashtu edhe stallën , sepse ka shumë kërkesa për djathë për të cilin thotë se është fitimprurës nëse punohet me përkushtim. Sadeti është shumë mirënjohëse ndaj organizatës IADK dhe stafit profesional të saj për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme e cila ka bërë që ajo ta ndjej veten më të sigurt në fermën e saj .

Infrastruktura teknike -


Prej janarit 2009 IADK është vendosur me zyrët dhe sallë për trajnime në Qendert të Mitrovicës si është kompletur me inventare për zyre dhe makina (8 copë) për punë në teren

Stafii i IADK-se per vitin 2009

Emri dhe mbiemri	Pozita	Bashkangjiture IADK-së
Zenel Bunajku	Drejtor Ekzekutive	Nga fillimi 2005
Mr Vahid Avdiu	Hortikulture –Perime	2007
Rifat Bajraktari	Hortikulture –Pemë	2007
Esmazemi	Zyrtare e Financave	2007
Hanumshahe Zeneli	Zyrtare e Preojktit - Përpunim	2009 gjysem orari
Alush Musaj	Blegtori -Veterinari	15 shkurt deri 15 korrik 2009
Gursel Arifi	Blegtori	Prej 15 gushtit
Elheme Shala	Mbështetkje teknike	2009 gjysëm orari

Buxheti i IADK-së për vitin 2009

Donatorët	Të hyrat	Shpenzimet		
		Shpenzimet direkte	Shpenzimet e implementimit	Shpenzimet totale
Fin Church Aid	203,822	134,774	69,048	203,822
Evangelischer Entwicklungsdienst-EED	65,153	56,330	8,822	65,153
DANBAT	4,000	3,976	24	4,000
Mercy Corps	3,700	450	77	527
Kontributet Lokale	67,175	67,175	-	67,175
LWF Capital Grant	18,250	18,250	-	18,250
Total	362,100	280,956	77,971	358,927





Adresa
Rr Mbretresha Teutë Nr. Pn.
40000 Mitrovicë
Kosovë/ a

www.iadk.org
info@iadk.org
Tel/Fax: +386 (0) 43 722 092
Mob: +377 (0) 44 198 056